



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 137 Akti

Nr. 81 Vendimi
Tiranë, më 26.11.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bektoshi	Kryesues
Olsi Komici	Anëtar
Roland Ilia	Relator

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, më datë 21 nëntor 2018, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i parë, salla ovale, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Fiona Papjorgji**, me detyrë këshilltare ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;
Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit së çështjes, z. Roland Ilia, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht dhe pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. **Komisioni i Pavarur i Kualifikimit**, është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në nenin 179/b, paragrafi 5 të ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në nenin 3, pika 5 dhe nenit 5, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. **Subjekti i rivlerësimit, znj. Fiona Papajorgji, me funksionin këshilltare ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese**, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 4 të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (këtu e më poshtë referuar si “**Komisioni**”), ka hedhur shortin, më datë 15.05.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Fiona Papajorgji, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 1, i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Roland Ilia dhe Brunilda Bekteshi. Relator i çështjes, u zgjodh me short, komisioneri Roland Ilia. Me vendimin nr. 40, datë 16.07.2018, Komisioni vendosi që komisionerja Alma Faskaj, të zëvendësohet nga komisioneri Olsi Komici .

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 24.05.2018 u caktua me mirëkuptim kryesuese znj. Brunilda Bekteshi, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Fiona Papajorgji.

5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, znj. Fiona Papajorgji, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, e veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, kishte për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

7. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD). Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

8. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016 u administrua shkresa me nr. *** prot., datë 05.02.2018, e **Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI)**, me anë të së cilës dërgohej një raport i hollësishëm dhe i arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Fiona Papajorgji. Në këtë raport, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt rivlerësimi, ILDKPKI-ja ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin dhe nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka mosdeklarime të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

9. **Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)** ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit me shkresën nr. *** prot., datë 26.10.2017 (deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 02.11.2018), në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Fiona Papajorgji.*

10. **Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë** ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

11. Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi tre kriteret, atë të vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale.

12. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe atë të figurës, më datë 02.11.2018, vendosi: i) përfundimin e hetimit kryesisht për këto tre kriteret për subjektin e rivlerësimit, znj. Fiona Papajorgji; ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

13. Subjekti i rivlerësimit, më datë 02.11.2018 u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes më datë 05.11.2018 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja më datë 19.11.2018

14. Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

15. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, me *e-mail*, më datë 19.11.2018.

16. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Fiona Papajorgji, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, më datë 21.11.2018, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i parë, salla ovale, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.

17. Subjekti i rivlerësimit, znj. Fiona Papajorgji, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, znj. Fiona Papajorgji, kërkoi nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

18. Znj. Fiona Papajorgji, ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ajo ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

19. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi. 19.1 Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

19.2 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

19.3 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

19.4 Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

19.5 Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Nr. 2/2017^[1] dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

20. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklarata e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga ana e subjektit pranë ILDKPKI-së; ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga DSIK-ja (dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga KLD; (e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

21. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti dhe ligjshmërisë së burimit dhe të krijimit të saj.

Dokumentacioni i analizuar përbëhet nga:

- Provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së;
- Provat e depozituara nga subjekti pranë Komisionit;
- Informacionet dhe të dhënat e administruara nga ky Komision nëpërmjet organeve shtetërore, personave fizikë dhe juridikë;

^[1] “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

- Shpjegimet dhe deklaratat e subjektit në përgjigje të pyetësorëve të drejtuar nga Komisioni, të rezultateve të hetimit administrativ dhe shpjegimet e dhëna në seancën dëgjimore.

21.1 Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratave të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Fiona Papajorgji, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të “Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”, të datës 23.01.2017, me nr. indeksi ***, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara pranë ILDKPKI-së, për vitet 2011 - 2016, në raport me të dhënat e “Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga bankat, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve - gjendje *cash*;
- ç) hetimeve të kryera lidhur me të dhënat e vetëdeklaruar nga subjekti i rivlerësimit kalimtar, gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga ana e Komisionit.

➤ **Në deklaratën “Vetting” të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar këto pasuri (të paluajtshme dhe të luajtshme):**

22. Apartament banimi¹, 1+1, me sipërfaqe 71 m², në adresën, Rr. “****”, pallati “****”, Tiranë, me vlerë 31.950 (tridhjetenjë mijë e nëntëqindpesëdhjetë) euro. Pjesa takuese: 100 %.

22.1 *Burimi i krijimit të kësaj pasurie në deklaratën “Vetting”*: Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi, kursimet familjare, bursat e përfituara gjatë studimeve të kryera në Itali, si edhe të ardhura nga puna e kryer.

22.2 *Mënyra e fitimit të pronësisë*: Kontrata e sipërmarrjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.01.2004, me palë porositëse subjektin e rivlerësimit dhe sipërmarrës shoqërinë ndërtuese “****” sh.p.k.

22.3 *Konkluzioni i ILDKPKI-së*: Subjekti nuk ka deklaruar në mënyrë analitike burimin e shumës prej 31.950 eurosh dhe nuk ka paraqitur dokumente justifikuese mbi burimin e kursimeve familjare, të cilat kanë shërbyer për blerjen e këtij apartamenti.

22.4 Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në *vërtetësinë e deklaratave të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie*.

22.5 *Deklarimi i kësaj pasurie ndër vite*: (1) deklaruar për herë të parë në deklaratën para fillimit të detyrës (dorëzuar pranë ILDKPKI-së, më datë 03.10.2011), pasuria apartament banimi, 1+1, me sipërfaqe 71 m², ndodhur në, Rr. “****”, pallati “****”, prenotuar sipas kontratës së sipërmarrjes, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.01.2004. Vlera e deklaruar 31.950 euro dhe pjesa takuese: 100 %; (2) subjekti nuk ka deklaruar detyrime të mbetura ndaj sipërmarrësit; (3) referuar DPV-ve vjetore të dorëzuara ndër vite pranë ILDKPKI-së

¹ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks nr. 4/1 në dosjen e ILDKPKI-së):

- kontratë sipërmarrje, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.01.2004;
- deklaratë notoriale, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 03.06.2004;
- deklaratë notoriale, nr. *** rep., datë 05.10.2004;
- kontratë shërbimi e lidhur mes subjektit dhe Universitetit të Barit (Itali), datë 23.07.1993.

konstatohet se, subjekti ka deklaruar si adresë ku është regjistruar në gjendjen civile: “Njësinë Administrative Nr. ***, blloku “****”, lagjja: nr. ***, pallati ***, Tiranë”, por gjithashtu ka deklaruar si vendqëndrim tjetër, adresë ku banon: “Njësia Administrative Nr. ***, Rr. “****”, pallati “****”, Tiranë”.

22.6 ZVRPP-ja Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 20.07.2018, nuk konfirmon regjistrimin i kësaj pasurie.

22.7 Në kontratën noteriale të sipërmarrjes, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.01.2004, të redaktuar nga noteri publik L. Gj, parashikohet se subjekti i rivlerësimit ka paguar në favor të përfaqësuesit të sipërmarrësit në prezencë të noterit, 50 % të vleftës së apartamentit dhe konkretisht shumë prej 15.975 eurosh.

22.7.1 Në këtë kontratë gjithashtu parashikohet se, kësti i dytë do paguhet nga porositësja me fillimin e shtrimit të pllakave dhe përbëhet nga 40 % e vleftës, konkretisht shuma prej 12.780 eurosh, ndërsa kësti i fundit që përbën 10 % të vlerës ose shuma prej 3.195 eurosh do të paguhej me përfundimin e pallatit.

22.7.2 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosje rezulton se, subjekti “Bjorn” sh.p.k., është pajisur nga K.RR.T Tiranë me leje ndërtimi nr. *** prot., datë 26.09.2003, për ndërtim, godinë banimi dhe shërbimi 2,8 dhe 10-katëshë me 1 kat parkim nëntokë, ndodhur në Rr. “****”.

22.7.3 Gjithashtu konstatohet se, nëpërmjet 2 deklaratave noteriale, datë 03.06.2004 dhe datë 05.10.2004, konfirmohen edhe dy pagesa të tjera të kryera nga porositësi znj. Fiona Papajorgji, në favor të firmës ndërtuese, konkretisht shumë prej 10.000 eurosh dhe 5.090 euro.

22.7.4 Referuar dokumentacionit të administruar rezulton se, subjekti i rivlerësimit ka paguar në total për këtë apartament shumë prej 31.065 eurosh, pra 885 euro më pak nga sa ishte rënë dakord në kontratën e sipërmarrjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.01.2004.

22.8 Nga Komisioni u pyet subjekti i rivlerësimit duke i kërkuar të na deklarojë në mënyrë analitike burimin e shumë prej 31.950 eurosh, shumë e paguar për likuidimin e apartamentit të prenotuar në vitin 2004, si edhe të na paraqesë dokumentacion justifikues mbi kursimet familjare, të deklaruara si një prej burimeve të prenotimit të kësaj pasurie. Gjithashtu, iu kërkua subjektit të japë shpjegime lidhur me shpenzimet e kryera nga ana e saj gjatë studimeve të kryera në shtetin Italian.

22.8.1 Në përgjigjet e dërguara pranë Komisionit, subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka deklaruar se, *burimet financiare që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit të ndodhur në Rr. “****”, janë: (1) bursa me vlerë neto 10.000.000 (dhjetë milion) lireta, e vitit 2000²; (2) të ardhurat nga kontrata me Universitetin e Barit, më datë 23.07.1997³, për 150 orë me pagesë 12.000 lireta ora; (3) të ardhurat e përfituara nga e motra e saj, znj. E. P⁴, (4) kursime nga puna ndër vite, të sajat dhe të familjarëve të saj.*

² sipas dokumentit të paraqitur në deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit (CUD 2001), dokumenti i bashkëlidhur edhe me përgjigjet e pyetësorit.

³ sipas dokumentit të paraqitur në deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit, dokumenti i bashkëlidhur edhe me përgjigjet e pyetësorit.

⁴ për të cilën sqaron se ka shkuar në shtetin Italian që në vitin 1991 pasi ka fituar një bursë studimi me vlerë 1.000.000 (një milion) lireta në muaj, për katër vitet e studimit në Universitetin e Barit. Subjekti shpjegon se, motra e saj ka pasur dy llogari brenda së njëjtës bankë (në shtetin Italian), conto corrente dhe deposito a risparmio dhe se që prej vitit 2002 ka bërë kalim shumë në llogari të familjes në Shqipëri. Gjithashtu subjekti sqaron se, motra e saj në vitin 2003 dhe 2004 ka tërhequr nga

22.9. Për sa i përket shpenzimeve deklararon se, në periudhën kur ka kryer studimet universitare (1994 - 2000) në Itali, ka qëndruar gjatë gjithë kohës në konvikte universitare, i fundit në konviktin “***”, në adresën Rr. “***” nr. ***, Bari, ku ka pasur dhe rezidencën në atë periudhë⁵.

22.10. Gjithashtu subjekti ka shpjeguar se, rajoni i Puglias në atë kohë u ka akorduar studentëve më të mirë, mundësinë për të qëndruar në konvikte universitare falas, vaktet në mensë falas dhe 2.000.000 lireta cash në vit. Duke qenë se, deklararon se i ka përmbushur këto kriteret, thotë se gjatë gjithë kohës së studimeve ka qëndruar në konviktet universitare dhe se ka konsumuar vaktet në mensat përkatëse.

22.11 Nga Komisioni **është pyetur sërish subjekti i rivlerësimit** lidhur me të ardhurat financiare të prindërve të saj para blerjes së apartamentit në vitin 2004.

22.11.1 Në përgjigjet e dërguara pranë Komisionit, subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka sqaruar se: “ Babai i saj në vitet 1994 - 1995 ka realizuar vënien në montim si dhe ka ndjekur më pas procesin e prodhimit në fabrikën e birrës të, z. H. Sh, në Vlorë, për të cilën thotë se ka marrë një kompensim financiar prej afërsisht 100.000 (njëqindmijë) lekë. Në vijim shpjegon se në vitin 1996 babai i saj është regjistruar si person fizik⁶ për të ushtruar veprimtari private në fushën « import - eksport, tregtim të mallrave industriale, ushqimore etj.,». Nga ky aktivitet thotë se, babai i saj ka pasur të ardhura prej afërsisht 120.000 lekë në muaj. Në vijim, subjekti i rivlerësimit sqaron sërish se, prej vitit 2001 deri në fund të vitit 2003, babai i saj ka punuar si ekspert kimist me licencë pranë shoqërisë “***” sh.p.k., (Vorë - Fushë Krujë) me të ardhura mesatare në shumën prej 90.000 - 100.000 lekësh në muaj. Gjithashtu subjekti ka shpjeguar se, mamaja e saj prej vitit 2002 ka punuar pranë shoqërisë “***” me të ardhura mujore në shumën prej 38.000 lekësh.

22.12 Komisioni ka konstatuar se, dokumentacioni i paraqitur nuk është në gjuhën zyrtare sipas parashikimeve të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si edhe shpjegimet e dhëna nga ana e subjektit lidhur me këtë pasuri nuk janë shteruese.

22.13 Për sa më sipër, i është kërkuar subjektit që: (1) gjithë dokumentacioni në gjuhë të huaj, dorëzuar lidhur me këtë pasuri, të përkthehet në gjuhën shqipe, të legalizohet dhe të noterizohet; (2) të depozitohet çdo dokumentacion të mundshëm lidhur me marrëdhëniet e punës së babait dhe nënës së subjektit për të ardhurat e përfituara, para vitit 2004; dhe (3) të shpjegojë në mënyrë kronologjike, të gjitha burimet e krijimit të kësaj pasurie duke përcaktuar dhe shumën e përafërta nga secili burim, të përdorura për blerjen e apartamentit.

22.14 Pasi i është kaluar barra e provës në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, subjekti i rivlerësimit, znj. Fiona Papajorgji, ka dërguar prapësimet e saj pranë Komisionit, ku ka shpjeguar në mënyrë analitike burimin e krijimit të kësaj pasurie, për të cilat ka paraqitur edhe provat përkatëse.

Ilogaria deposito a risparmio, shumën prej 7.000 eurosh (bashkëlidhur përgjigjeve të këtij pyetësi ka dorëzuar e-mail-e të shkëmbyera me Universitetin e Barit dhe Bancapulia, si dhe nxjerrje Ilogarie nga kjo bankë).

⁵ ka dorëzuar certifikatën e rezidencës

⁶ i ka bashkëlidhur deklaramit kopje të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. ***, datë 11.03.1996, për regjistrimin si person fizik të shtetasit Th. P.

22.15 Lidhur me këtë pasuri, mbas dërgimit të rezultateve të hetimit administrativ dhe kalimit të barrës së provës, subjekti ka vënë në dispozicion dokumentacion të përkthyer në gjuhën shqipe, nga përkthyes zyrtar dhe të noterizuar.

22.16 Më konkretisht, në mënyrë kronologjike dhe të përmbledhur të ardhurat e deklaruara nga ana e subjektit, që kanë shërbyer për blerjen e këtij apartamenti, janë pasqyruar si më poshtë:

- i. Të ardhura nga kontrata e punësimit për vitin 1997, në vlerën 1.800.000 lireta, konvertuar me kursin e kohës, vlera e përafërt prej 973 eurosh.
 - Dokumenti provues, kontratë e lidhur me Universitetin e Barit, më datë 23.07.1997, njësuar me origjinalin në Bashkinë e Sammichele di Bari, më datë 15.11.2018, nga e motra e subjektit të rivlerësimit, znj. E. P (*shih dokumentin nr. 6 në provat e paraqitura nga subjekti*).
- ii. Të ardhura nga bursa në Itali, viti 2000, në vlerën 10.000.000 lireta, konvertuar me kursin e kohës në vlerën 5.165 euro.
 - Dokumenti provues, CDU 2001, certifikim fiskal për vitin 2000 për të ardhurat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit përgjatë këtij viti, njësuar me origjinalin në Bashkinë e Sammichele di Bari, më datë 15.11.2018, nga e motra e subjektit të rivlerësimit, znj. E. P (*shih dokumentin nr. 7 në provat e paraqitura nga subjekti*). Sipas këtij dokumenti, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura bruto pranë autoriteteve italiane për vitin 2000, shumën prej 14.000.000 liretash dhe ndalesat janë në shumën 3.970.000 lireta, pra vlera neto e përfituar 10.030.000 lireta.

22.17. Gjithashtu, subjekti deklaroi se, *gjithë shumat si më lart janë përdorur për blerjen e apartamentit, pasi sikurse ka sqaruar edhe më parë gjatë gjithë kohës së studimeve universitare (1994 - 2000), të kryera në Bari, Itali, ka qëndruar në konvikte universitare falas, ka konsumuar vakte falas në mensa dhe ka marrë 2.000.000 lireta cash në vit me të cilat ka mbuluar shpenzimet e tjera. Ndërsa, pas përfundimit të studimeve universitare, prej vitit 2001, ka jetuar në Itali, gjatë gjithë kohës me motrën, sikurse rezulton nga certifikatat e gjendjes civile të Fiona dhe E. P, të legalizuara, përkthyer dhe noterizuara, që ka bashkëlidhur (dok. nr. 8 - 9), dhe se të gjitha të ardhurat e tjera të sajat apo të motrës që na ka vënë në dispozicion, kanë shërbyer për të mbuluar shpenzimet e tyre të jetesës në Itali.*

- iii. Shuma prej 7.000 eurosh e vënë në dispozicion nga motra e saj, për blerjen e apartamentit. Kjo shumë është tërhequr gjatë viteve 2003 - 2004 nga llogaria - deposito a risparmio e Bankapulia.
 - Dokument provues, certifikimi i depozitës së kursimeve nga “BANCAPULIA”, sipas shkresës, datë 17.09.2018, drejtuar znj. Fiona Papajorgji.
 - Nga verifikimi i kësaj llogarie konfirmohet se, gjatë periudhës janar 2003 - janar 2004, znj. E. P, ka tërhequr nga depozita e saj e kursimit shumën prej 7.009 eurosh.

22.18 Si burim i krijimit të kësaj shume janë: (1) *bursa e studimit me vlerë neto 8.000.000 (tetë milion) lireta e vitit 2001, marrë në Itali nga motra e subjektit, znj. E. P, sipas dokumentit “Lajmërim për pagesë” i përkthyer në gjuhë zyrtare dhe i noterizuar, të cilën subjekti ja ka bashkëlidhur prapësimeve (dok. nr. 12), si dhe (2) kursime nga të ardhurat në vite të motrës së saj, referuar deklaratave të të ardhurave të viteve 2000, 2001, 2002, 2003, sipas dokumentacionit të përkthyer, legalizuar dhe noterizuar që ka bashkëlidhur në prapësimet e saj (dok. nr. 13-14-15-16).*

- iv. Të ardhurat e babait të saj për periudhën, qershor 2002 - shtator 2004, nga punësimi i tij pranë “****” sh.p.k dhe “****” sh.p.k.
- viti 2002, vlera prej 3.935 eurosh;
 - viti 2003, vlera prej 8.530 eurosh;
 - viti 2004, vlera prej 6.390 eurosh.
- Total vlera 18.855 euro.
- Subjekti ka bashkëlidhur vërtetime nga këto shoqëri (dok. nr. 17 - 18) dhe sqaron se nga këto të ardhura, vlerat prej **90.000/95.000** lekësh në muaj janë përdorur si kursime për blerjen e apartamentit, ndërsa pjesa tjetër, së bashku me të ardhurat e nënës së subjektit, znj. D. P, kanë shërbyer për të mbuluar shpenzimet e jetesës së prindërve. Dokumentacioni provues: (1) vërtetim, datë 05.11.2018, nga shoqëria “****” sh.p.k.; (2) vërtetim, datë 06.11.2018, nga shoqëria “****” sh.p.k.

Analiza ligjore përfundimtare lidhur me këtë pasuri.

22.19 Komisioni, vëren se kjo pasuri është krijuar në vitin 2004, vit në të cilin subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë subjekt deklarimi pranë ILDKPKI-së dhe nuk ka pasur ndonjë funksion shtetëror. Subjekti është emëruar, më datë 05.09.2011, në detyrën e këshilltares ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese dhe më datë 03.10.2011, ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së, “Deklaratën e Interesave Private Para Fillimit të Detyrës”. Pra, rezulton se fitimi i kësaj pasurie është realizuar rreth 7 vjet përpara se subjekti të fillonte funksionin e saj si këshilltare ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese. Konstatohet se, në deklaratën para fillimit të detyrës si edhe në deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri.

22.20. Pasuria e znj. Papajorgji, e deklaruar në Formularin-Vetting, duhet t’i nënshtrohet një kontrolli të plotë, përfshi këtu edhe pasuritë e vendosura gjatë kohës që ajo nuk ushtronte funksionin e këshilltares ligjore në Gjykatën Kushtetuese, për t’u siguruar se funksionari publik është një person me integritet dhe nëse e gjithë pasuria e tij është e ligjshme.

22.21. Nga ana tjetër, pasuritë e vendosura para detyrës duhet të analizohen rast pas rasti në kuptim të vlerësimit të besueshëm lidhur me origjinën e tyre të ligjshme dhe provat që disponohen. Për këtë arsye, në këto rrethana nevojitet një qasje më fleksibel, edhe në këndvështrimin e informalitetit të ekonomisë që e ka karakterizuar Shqipërinë gjatë viteve të caktuara. Qëllimi kryesor i ekzistencës së rivlerësimit mund të gjendet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, “*Sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi*”. Bazuar në këtë përkufizim, zbatimi i ligjit të rivlerësimit në kohë duhet të kryhet në analogji me parimet e përcaktuara në këtë përkufizim dhe që mund të lidhet me të gjithë komponentët e sistemit të rivlerësimit.

22.22. Kjo pasuri është vënë nga subjekti i rivlerësimit në periudhën kohore kur ajo nuk kishte funksionin e këshilltares.

22.23. Në të tilla rrethana faktike dhe juridike, vlerësojmë se duken bindëse dhe të bazuara në prova shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe se nuk ka dyshime lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie.

23. Autoveturë, tip “Seat Ibiza”⁷, me vlerë 10.620 (dhjetë mijë e gjashtëqindënjëzet) euro, në bashkëpronësi me babain e subjektit, z. Th. P, me pjesë takuese në emrin e saj, 35 %.

23.1 *Burimi i krijimit të kësaj pasurie në deklaratën “Vetting”*: Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar, shumën prej 7.000 eurosh, nga kursimet familjare të paguara *cash* nga babai i saj si edhe shumën prej 3.620 eurosh të financuar me kontratë qiraje financiare, deklaruar si të likuiduar nga ana e saj me të ardhurat e përfituara nga pagat.

23.2 *Mënyra e fitimit të pronësisë*: Kontrata e qirasë financiare, nr. *** dhe nr. *** rep., nr. *** kol., më datë 28.10.2010.

23.3 *Deklarimi i kësaj pasurie ndër vite*: Deklaruar për herë të parë në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, më datë 03.10.2011.

23.4 *Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri*: Subjekti nuk ka depozituar dokumente justifikues për babin e saj, mbi burimin e shumës prej 7.000 eurosh.

23.5 *Hetimi i kryer nga Komisioni u përqendrua në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie*.

23.6 **“Landeslease” sh.a**, me shkresën nr. *** prot., datë 04.07.2018, protokolluar pranë Komisionit, me shkresën, nr. *** prot., datë 05.07.2018, na konfirmon se, kjo shoqëri ka lidhur kontratën e qirasë financiare⁸ me znj. Fiona Papajorgji, me anë të së cilës është financuar për automjetin, tip “Seat Ibiza”, me të dhënat si më poshtë:

- i. çmimi i blerjes së objektit të qirasë (TVSH e përfshirë): në vlerën prej **10.620 eurosh**;
- ii. parapagimi (TVSH e përfshirë) 65.9 % e çmimit të blerjes, vlera prej 7.000 eurosh;
- iii. shuma e financuar (TVSH e përfshirë) 34.1 % e çmimit të blerjes, vlera prej 3.620 eurosh;
- iv. komisioni i administrimit (TVSH e përfshirë) 1.5 % e shumës së financuar, vlera prej 54 eurosh;
- v. afati i qirasë financiare: 24 muaj;
- vi. interesi: min 10.0 % EURIBOR, me maturim 6 mujor + 7.5 %.

23.6.1 Referuar shtojcës “F” të kësaj kontrate të qirasë financiare konstatohet se, subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar urdhrin për pagesa periodike (transferta) deri në pagesën e fundit, më datë 21.09.2012, nga llogaria e saj në llogarinë e “Landeslease” sh.a (euro - account), pranë “Raiffeisen Bank”, por pa përcaktuar llogarinë bankare të subjektit dhe numrin e saj.

23.6.2 Nga verifikimi i kartelës së pagesave të kryera nga subjekti i rivlerësimit rezulton se është shlyer tërësisht detyrimi që subjekti i rivlerësimit ka pasur ndaj shoqërisë “Landeslease” sh.a., nga ku në total shuma e paguar është në vlerën prej **11.063,38 eurosh** (këtu përfshihet shuma e parapaguar, këstet e paguara për shumën e financuar, komisionet dhe interesat).

23.6.3 **“Intesa Sanpaolo Bank”**, me shkresën nr. *** prot., datë 02.07.2018, protokolluar pranë Komisionit me shkresën, nr. *** prot., datë 04.07.2018, ndër të tjera na dërgon të dhëna lidhur me llogarinë e subjektit të rivlerësimit në këtë bankë.

⁷ subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së):

- kontratë qiraje financiare, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.08.2010;
- kontratë shitblerje, nr. *** , lidhur mes “Porche Albania” sh.a., dhe subjektit të rivlerësimit;
- kontratë shitje, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.08.2012;
- 2 mandatarkëtime të datës 05.08.2010 dhe 20.08.2010, lëshuar nga “Porche Albania” dhe arkëtuar nga z. Th. P;
- vërtetim për detyrimet e shlyera, nr. *** prot., datë 10.04.2012, lëshuar nga “Landeslease” sh.a.

⁸ kontrata e qirasë financiare, nr. *** , nr. *** rep., nr. 2350 kol, datë 28.10.2010, redaktuar nga noteri publik J. Zh.

23.6.4 Nga verifikimi i nxjerrjes së llogarisë së subjektit të rivlerësimit pranë “Intesa Sanpaolo Bank” konstatohet se, pagesat në favor të shoqërisë “Landeslease” sh.a., subjekti i rivlerësimit i ka kryer nëpërmjet llogarisë në monedhën euro me nr. ***, konkretisht përgjatë periudhës tetor 2010 - gusht 2012.

23.6.5 Nga analiza financiare e kryer rezultoi se, subjekti ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht kryerjen e këtyre pagesave.

23.7 Nga ana jonë iu kërkua subjektit të rivlerësimit të na konfirmojë pagesën *cash*, në shumën prej 7.000 eurosh, të kryer nga babai i subjektit për blerjen e këtij automjeti si edhe të na paraqesin dokumente justifikues mbi burimin e kësaj gjendje *cash* nga ana e babait të subjektit.

23.7.1 Në përgjigjet e sjella pranë Komisionit, subjekti i rivlerësimit na konfirmon se, në datat 05.08.2010 dhe 20.08.2010 nga babai i subjektit, z. Th. P, janë kryer dy pagesa *cash*, respektivisht në vlerën 1.700 euro dhe 5.300 euro pranë shoqërisë “Porsche Albania”, me qëllim blerjen e autoveturës, tip “Seat Ibiza”, duke na dërguar edhe kopje të mandatarkëtimeve lidhur me këto pagesa. Nga verifikimi i këtyre mandateve konstatohet se, ato mbajnë vulën e shoqërisë “Porsche Albania”, dhe janë nënshkruar nga përfaqësuesi i shoqërisë dhe z. Th. P.

23.7.2 Lidhur me pagesën në vlerën 7.000 euro nga babai i subjektit, *subjekti i rivlerësimit deklaron se, si burim i krijimit të kësaj gjendje ka qenë shumat e marra për shitjen e apartamentit në bllokun “****”, lagjja nr. ***, pallati nr. ***, Tiranë. Në vijim, subjekti i rivlerësimit shpjegon se, në vitin 2009 babai i saj kishte rënë dakord me shtetasin K. Sh për të shitur këtë apartament dhe se për këtë qëllim pala blerëse në një hark kohor 2-vjeçar i ka dhënë shumën prej 89.700 eurosh, sipas deklaratës noteriale, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.02.2011. Shitja e kësaj pasurie është dokumentuar përfundimisht me kontratën, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.05.2011.*

23.7.3. Referuar dokumentit, “*deklaratë noteriale*”, me nr. *** rep., nr. *** kol., më datë 21.01.2011, redaktuar nga noteri publik V. D, rezulton se shtetasi Th. P, ka deklaruar se gjatë periudhës 2-vjeçare i ka marrë z. K. Sh shumën prej 87.000 eurosh dhe 200.000 lekësh dhe se këtë shumë e ka marrë si pagesë për një apartament të cilin ai do t’ia shesë këtij të fundit. Referuar dokumentit, “*kontratë shitje pasurie të paluajtshme*”, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.05.2011, redaktuar nga noteri publik znj. A. N, konfirmohet shitja e apartamentit në pronësi të babait të subjektit të rivlerësimit, me subjekt blerës shtetasin K. Sh.

23.8 Me shkresën nr. *** prot., datë 29.10.2018, i jemi drejtuar noterit publik L. D, të cilit i ka kaluar në administrim arkiva e noterit V. D, me qëllim konfirmimin e kësaj deklarate noteriale.

23.8.1 Noteri L. D, me shkresën drejtuar Komisionit, protokolluar pranë Komisionit, nr. *** prot., datë 13.11.2018, na dërgon kopje të deklaratës noteriale, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.02.2011, të përpiluar nga ish-noteri V. D. Nga verifikimi i kësaj deklarate noteriale konfirmohet se ajo është e njëjtë në formë dhe në përmbajtje me deklaratën e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit.

23.9. Për sa më sipër, Komisioni, çmon se shpjegimet e dhëna lidhur me burimin e shumës prej 7.000 eurosh të paguara nga babai i saj për blerjen e këtij automjeti, duken bindëse dhe të bazuara në dokumentacion provues dhe se nuk ka dyshime lidhur me pagesën e kësaj shume.

23.9 **DPSHTRR-ja**, me shkresën nr. *** prot., datë 02.07.2018, ndër të tjera na konfirmon se subjekti i rivlerësimit dhe babai i subjektit, aktualisht kanë në pronësi mjetin me targë ***.

Komisioni vlerëson se, ky është automjeti tip “Seat Ibiza”, deklaruar nga subjekti si pasuri në bashkëpronësi me babain e subjektit.

23.10 Nga verifikimi i kryer i dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së konfirmohet se, automjeti tip “Seat Ibiza” është regjistruar me targa *** dhe se blerja e tij nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe babait të saj është formalizuar me kontratën e shitjes, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.08.2012, redaktuar nga noteri publik z. J. Zh.

23.11 Komisioni, vlerëson se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar në dosje si edhe nuk ka dyshime lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.

24. Autoveturë, tip “Ford Ka”⁹, e blerë, më datë 15.04.2008, në Itali (me targa italiane), për vlerën prej 1.500 (njëmijë e pesëqind) eurosh.

24.1 *Burimi i krijimit të kësaj pasurie në deklaratën “Vetting”*: Si burim të krijimit ka deklaruar kursimet e saj.

24.2 *Deklarimi i kësaj pasurie ndër vite*: Deklaruar për herë të parë në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, më datë 03.10.2011. Ka deklaruar se, ky automjet është prodhim i viti 1997 dhe se është blerë nga ana e saj, më datë 15.04.2008, në shtetin italian.

24.3 *Konkluzioni i ILDKPKI-së*: Subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumente justifikues për blerjen e këtij automjeti dhe DPSHTRR-ja nuk e konfirmon këtë automjet të regjistruar.

24.4 **DPSHTRR-ja**, me shkresën nr. *** prot., datë 02.07.2018, protokolluar pranë Komisionit me shkresën, nr. *** prot., datë 03.07.2018, nuk konfirmon regjistrimin e këtij automjeti.

24.5 E pyetur nga ana jonë për këtë automjet, dokumentacionin lidhur me blerjen e tij dhe faktin nëse ky automjet është aktualisht në qarkullim apo jo, subjekti i rivlerësimit ndër të tjera na deklaroi se: *“Automjeti, tip “Ford Ka”¹⁰ është blerë nga ana e saj, më datë 15.04.2008, për shumën prej 1.500 eurosh dhe se është prodhim i vitit 1997. Për posedimin e këtij automjeti sqaron se nuk disponon dokumentacion justifikues. Lidhur me burimin e krijimit, rikonfirmon se ky automjet është blerë nga kursimet e saj. Në vijim, ajo shpjegon se automjeti ndodhet në Shqipëri, por nuk është në qarkullim, pasi prej disa vitesh nuk është në gjendje funksionale”*.

24.6 Komisioni, ka vlerësuar se subjekti duhet të dërgojë foto të këtij automjeti me qëllim verifikimin e gjendjes aktuale të tij, për konfirmimin e deklarimeve të dhëna.

24.7 Lidhur me këtë çështje (automjetin, tip “Ford Ka”, prodhim i vitit 1997), pas dërgimit të rezultateve të hetimit administrativ dhe kalimit të barrës së provës, subjekti përfundimisht ka sqaruar se: *“Ky automjet që prej pothuajse 3 vjetësh nuk ka qenë në gjendje funksionale, për shkak të një defekti motorik të pariparueshëm dhe dëmtime të tjera xhenerike nga përdorimi dhe amortizimi. Që prej atij momenti automjeti nuk ka qenë më në qarkullim. Për këtë arsye në fillim të vitit 2016 është lënë pranë një pike makinash të përdorura, konkretisht në pikën me administrator S. H, në ***, Durrës. Pas një periudhe të gjatë kohe qëndrimi pranë kësaj pike, duke qenë se nuk kishte më asnjë mundësi që automjeti të ishte funksional dhe të përdorej, si*

⁹ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks nr. 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së):

- dokumente në gjuhën italiane për automjetin, tip “Ford Ka”, me targë ***.

¹⁰ ka bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit, kopje të librezës së këtij automjeti, në gjuhën italiane.

dhe vlera e qëndrimit po tejkalonte vetë vlerën e makinës, është vendosur që ky mjet të kalonte për skrap (dok. nr. 24).

➤ Dokument provues, vërtetim, më datë 12.11.2018, nga subjekti “S. H” p.f.

24.8 Komisioni, çmon se duken bindëse dhe të bazuara në prova shpjegimet e subjektit lidhur me gjendjen e këtij automjeti dhe destinacionit final të tij, si edhe nuk ka dyshime lidhur me burimin që ka shërbyer për blerjen e tij.

25. Depozitë bankare¹¹, pranë “Raiffeisen Bank” (Fondi i Investimeve), vlera 6.580.943 lekë.

25.1 Subjekti, ka deklaruar lidhur me këtë depozitë:

- i. *Kapitalin e investuar*: në vlerën prej 5.300.000 (pesë milion e treqind mijë) lekësh;
- ii. *Interesin e përfutur*: në vlerën prej 1.280.943 (një milion e dyqindetëdhjetë mijë e nëntëqindëzvetekatër) lekësh.

25.2 *Burimi i krijimit të kësaj pasurie në deklaratën “Vetting”*: Ka deklaruar si burim të krijimit: (1) *bursën e studimit nga BE*, me vlerë prej 40.915,41 (dyzetmijë e nëntëqindëpesëmbëdhjetë pikë dyzetënjë) eurosh, rreth 35.000 (tridhjetë e pesëmijë) euro neto; *si edhe* (2) *interesat e përfutuara për shumën e investuar*.

25.3 *Konkluzioni i ILDKPKI-së*: Subjekti ka paraqitur dokumente justifikues në lidhje me bursën e përfutur, por nga ana tjetër nuk ka paraqitur dokumente justifikues mbi shpenzimet e studimeve, në mënyrë që të ishte e mundur përlllogaritja se sa ka qenë mundësia e subjektit për të kursyer nga bursa.

25.4 *Deklarimi ndër vite i kësaj pasurie*:

- i. Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, të dorëzuar nga ana e subjektit, më datë 03.10.2011, pranë ILDKPKI-së, konstatohet se ka deklaruar:
 - bono thesari pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, datë 19.05.2011, për një periudhë një vjeçare, shumën prej 3.000.000 lekësh;
 - bono thesari pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, datë 16.06.2011, për një periudhë një vjeçare, shumën prej 350.000 lekësh;

Konstatohet se, subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të këtyre bonove të thesarit.

- ii. Referuar DPV 2012, ndër të tjera subjekti ka deklaruar si shtesë pasurie edhe likuiditetet si më poshtë:
 - shumën prej 350.000 lekësh, në bono thesari pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, datë 14.12.2012, me periudhë 1-vjeçare. Si burim krijimi ka deklaruar interesat nga bonot e mëparshme;
 - shumën prej 1.600.000 lekësh, në bono thesari pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, datë 31.10.2012, me periudhë 1-vjeçare. Si burim të krijimit ka deklaruar bursën nga BE, pas marrjes së titullit “doktor”, në Itali;

¹¹ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks nr. 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së):

- nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Invest”, datë 19.01.2017.
- dy dokumente (të datave 19.10.2010 dhe 02.08.2012), të lëshuara nga Regione Puglia, Itali, për bursën e studimit në shumën prej 40.915 eurosh;
- dokument i lëshuar nga agjensia e hyrjeve në Itali;
- deklaratata të ardhurash për personat fizik në Itali, për vitet 2005, 2006 dhe 2007;
- kërkesa për shpërndarjen e kontributeve, të datave 19.10.2010 dhe 02.08.2012.

- shumë prej 200.000 lekësh, pranë “Intesa Sanpaolo Bank”. Si burim të krijimit ka deklaruar bursën nga BE, pas marrjes së titullit “*doktor*”, në Itali;
- iii. Referuar DPV 2013, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka deklaruar:
 - depozitë bankare pranë “Raiffeisen Bank” dhe si burim të krijimit ka deklaruar kalimin e shumës nga bono thesari në depozitë. Gjithashtu deklaroi se shuma nuk ka ndryshuar nga deklaratimet e mëparshme, por thjesht ka ndryshim banke.
- iv. Referuar DPV 2014, konstatohet se subjekti ka deklaruar depozitë bankare pranë “Raiffeisen Bank” dhe shpjegon se nuk ka ndryshim të shumës nga deklaratimet e mëparshme, por thjesht disa lëvizje të kryera brenda vitit në këtë llogari.
- v. Referuar DPV 2015, konstatohet se subjekti ka deklaruar si shtesë pasurie shumë prej 300.000 lekësh, si interesa të përfituara nga depozita në “Raiffeisen Bank”.
- vi. Referuar DPV 2016, konstatohet se subjekti ka deklaruar si shtesë pasurie shumë prej 400.000 lekësh, që përfaqësojnë interesat bruto të përfituara nga depozita në “Raiffeisen Bank”, të patërhequra nga ana e saj por të investuara automatikisht.

25.5 *Hetimi i kryer nga Komisioni u përqendrua në vërtetësinë e deklaratimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.*

25.6 “**Intesa Sanpaolo Bank**”, me shkresën nr. *** prot., datë 02.07.2018, protokolluar pranë Komisionit me shkresën, nr. *** prot., datë 04.07.2018, na konfirmon se subjekti i rivlerësimit ka pasur llogari pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, me nr. *** (*Base Number*).

25.6.1 Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ana e kësaj banke, konstatohet se:

- i. më datë 31.12.2007, subjekti i rivlerësimit ka gjendjen, prej 1.000.000 lekësh në bono thesari;
- ii. më datë 30.12.2011, subjekti i rivlerësimit ka gjendjen prej, 3.350.000 lekësh në bono thesari;
- iii. më datë 31.12.2012, subjekti i rivlerësimit disponon: (1) gjendjen prej 5.300.000 lekësh në bono thesari dhe (2) gjendjen prej 200.000 lekësh në depozitë.

25.6.2 Gjithashtu nga verifikimi i lëvizjeve të kësaj llogarie, ndër të tjera vërehet se:

- i. më datë 06.11.2007, nga subjekti i rivlerësimit është depozituar *cash*, shuma prej 1.001.800 lekësh, me përshkrimin, “*kursime nga puna*”;
- ii. më datë 20.11.2008, është tërhequr *cash*, shuma prej 992.570 lekësh, me përshkrimin “*blerje shtëpie*”;
- iii. më datë 21.12.2011, në llogarinë në monedhën euro është depozituar *cash* nga subjekti i rivlerësimit, shuma prej 20.000 eurosh, me përshkrimin, “*bursë studimi*”;
- iv. më datë 03.05.2011, shuma prej 20.099 eurosh është transferuar në llogarinë në lekë të subjektit të rivlerësimit me përshkrimin, “*për bono thesari*”, konvertuar në shumë prej 2.856.067 lekësh;
- v. më datë 02.06.2011, është depozituar *cash*, shuma prej 350.000 lekësh;
- vi. më datë 26.10.2012, është depozituar *cash*, shuma prej 1.600.000 lekësh me përshkrimin, “*bursë studimi nga BE*”;
- vii. përgjatë vitit 2012 janë kryer disa depozitime *cash* nga subjekti i rivlerësimit, mbi bazën e të cilave, më datë 12.11.2012, është krijuar depozita prej 200.000 lekësh.

25.7 “**Raiffeisen Invest**” sh.a., me shkresën nr. *** prot., datë 30.06.2018, protokolluar pranë Komisionit me shkresën, nr. ***, konfirmon se subjekti i rivlerësimit ka marrëdhënie juridike

me këtë shoqëri pasi ka investuar në “Fondin Prestigj”, më datë 25.06.2018, dhe ka në këtë Fond, gjendje në shumën 6,929,143.73 lekë.

25.8. Lidhur me shpenzimet e kryera gjatë kohës që ka qenë me studime në Itali dhe ka përfituar bursa studimi, sikurse e kemi evidentuar edhe më lart, në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga ana jonë subjekti i rivlerësimit, ka shpjeguar se, Rajoni i Puglias (ku ajo ka kryer studimet) në atë kohë u ka akorduar studentëve më të mirë, mundësinë për të qëndruar në konvikte universitare falas, vaktet në mensë falas dhe 2.000.000 lireta cash në vit. Duke qenë se, deklaron se i ka përmbushur këto kritere, thotë se gjatë gjithë kohës së studimeve ka qëndruar në konviktet universitare dhe se ka konsumuar vaktet në mensat përkatëse.

25.9. Më qëllim konfirmimin e burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, subjektit i është kërkuar që, i gjithë dokumentacioni në gjuhë të huaj i depozituar pranë këtij Komisioni, të përkthehet në gjuhën shqipe, të legalizohet dhe të noterizohet si edhe të japi shpjegime lidhur me shpenzimet e kryera gjatë kohës së krijimit të kësaj depozite.

25.10. Pasi i është kaluar barra e provës në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, subjekti i rivlerësimit, znj. Fiona Papajorgji, ka dërguar prapësimet e saj pranë Komisionit, ku ka dhënë shpjegime dhe paraqitur prova të reja.

25.11. Lidhur me depozitën bankare pranë “Raiffeisen Bank” (Fondi i Investimeve), mbas dërgimit të rezultateve të hetimit administrativ dhe kalimit të barrës së provës, subjekti ka vënë në dispozicion dokumentacion të përkthyer në gjuhën shqipe, nga përkthyes zyrtar, dhe të noterizuar.

➤ Dokumentacioni provues i depozituar nga ana e subjektit: (1) Vendimi i Drejtuesit të Shërbimit të Formimit Profesional, datë 3 mars 2010, nr. 436, publikuar në Buletinin Zyrtar të Rajonit të Puglias, nr. ***, datë 11.03.2010, sipas dokumentit të përkthyer dhe noterizuar i cili është bashkëlidhur prapësimeve (dok. nr. 21); (2) Dokument nga Rajoni i Puglias, Zona e Programimit dhe Financës, njësuar me origjinalin në Bashkinë e Sammichele di Bari, më datë 15.11.2018, nga e motra e subjektit të rivlerësimit, znj. E. P (dok. nr. 22); (3) dokument i mbylljes së llogarisë në “Bankën Credem”.

25.11.1. Sipas dokumentacionit, bursa i është akorduar në dy këste:

- i. kësti i parë prej 22.362,73 eurosh (neto) më është akorduar në muajin dhjetor të vitit 2010, sipas dokumentit përkatës bashkëlidhur prapësimeve, i përkthyer dhe noterizuar, (dok. nr. 22), pranë “Bankës Credem”, në të cilën subjekti ka pasur llogari bankare në atë kohë në Itali;
- ii. në qershor të vitit 2012 subjekti deklaron se ka marrë titullin doktor, i njësuar nga Ministria e Arsimit të Republikës së Shqipërisë. Pas marrjes së titullit doktor në muajin tetor 2012, deklaron se i është akorduar pjesa e dytë e bursës në fjalë. Edhe ky këst i është kaluar pranë “Bankës Credem”, Bari, Itali. (nuk ka dokument provues).

25.11.2. Pas tërheqjes së kështit të dytë subjekti shpjegon se, ka mbyllur edhe llogarinë në atë bankë, sipas dokumentacionit të përkthyer dhe noterizuar që i ka bashkëlidhur prapësimeve të saj (dok. nr. 23).

25.12. Lidhur me shpenzimet për periudhën e studimeve të doktoratës (2009 - 2011) subjekti ka sqaruar se, gjatë asaj periudhe nuk ka banuar në Itali, por në Shqipëri, pasi për të frekuentuar kursin e doktoratës nuk ka qenë i nevojshëm dhe as i domosdoshëm qëndrimi në Itali. Gjithashtu, shpjegon se gjatë kësaj periudhe ka shkuar në Itali vetëm disa herë gjatë vitit, ku

ka qëndruar për disa ditë, me qëllim për të marrë pjesë në takimet e caktuara nga Universiteti për kursin e doktoratës. Si shpenzime ka pasur vetëm shpenzimin e biletave të avionit, pasi thotë se ka qëndruar në shtëpinë e motrës së saj në Bari, në “Via Francesco Tenente de Liguori”, nr. 1.

25.13. Komisioni, çmon se duken bindëse dhe të bazuara në prova shpjegimet e subjektit dhe nuk ka dyshime lidhur me burimin që ka shërbyer për krijimin e kësaj depozite në “Raiffeisen Bank”.

25.14. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjektit gjithashtu i është kërkuar: (1) të na japi shpjegime dhe të paraqesë dokumentacion justifikues lidhur me burimin e krijimit të shumës prej rreth 1.000.000 lekësh, të depozituar nga ana e saj, pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, në vitin 2007 si edhe (2) të na jepni shpjegime për destinacionin e shumës prej 992.570 lekësh, të tërhequr *cash* nga ana juaj, më datë 20.11.2008, nga “Intesa Sanpaolo Bank”, me përshkrimin, “*blerje shtëpie*”.

25.14.1. Lidhur me këto transaksione subjekti ka shpjeguar se, në tetor të vitit 2007, ka filluar bashkëpunimin me Universitetin “Zoja e Këshillit të Mirë” dhe “Albanian University” (sipas dokumenteve të këtyre universiteteve bashkëlidhur deklaratës “*Vetting*”), arsye për të cilën ka ardhur shpesh në Tiranë. Në atë kohë së bashku me prindërit e saj, ka vendosur që kursimet familjare (vitet 2005 - 2007), nga puna e babait të saj, t’i depozitonin në bankë për të gjeneruar të ardhura. Për këtë qëllim thotë se, më datë 06.11.2007, nga ana e saj është depozituar *cash* shuma prej 1.001.800 lekësh, për ta investuar në bono thesari për një periudhë 1-vjeçare. Sikurse e ka sqaruar në prapësimet e saj, pretendon se deri në nëntor të vitit 2006 babai i saj, z. Th. P,i ka punuar pranë “***” s.hp.k., dhe “***” sh.p.k., me të ardhura mujore prej 130.000 lekësh, ndërsa prej vitit 2007 deri në vitin 2010 ka punuar pranë “***” sh.p.k., dhe më vonë “***” sh.p.k., me një të ardhur mujore prej 150.000 lekësh në muaj. Ajo thotë se, ai ka realizuar montimin e shoqërisë “***” sh.p.k., në të cilën ka qenë edhe administrator, sikurse rezulton për këtë të fundit nga ekstrakti historik i shoqërisë (dok. nr. 20). Në vijim subjekti sqaron se, pas përfundimit të periudhës 1-vjeçare të investimit, shuma e lartpërmendur është tërhequr në nëntor të vitit 2008, dhe pjesa dërrmuese (rreth 75 % të shumës, është përdorur për disa investime të domosdoshme për shkak të amortizimit në shtëpinë e prindërve të saj dhe një pjesë tjetër për disa rregullime në shtëpinë e saj në rrugën “***”, ku dhe ka jetuar pasi u kthye përfundimisht në Shqipëri (në fund të vitit 2008). Në momentin kur ka tërhequr shumën në bankë, ka deklaruar se ajo i shërbente për “*blerje pajisje/orendi shtëpie*”, edhe pse banka në përshkrimin përkatës ka shënuar “*blerje shtëpie*”, çka duke konsideruar vlerën në fjalë, kuptohet që është lapsus i bankës. Me këtë qëllim, sqaron se nuk kam blerë dhe as disponon asnjë pasuri të paluajtshme (shtëpi), brenda dhe jashtë vendit, përveç apartamentit të ndodhur në rrugën “***”.

25.15. Komisioni, çmon se duken bindëse dhe të bazuara në prova shpjegimet e subjektit lidhur me arsyet e kryerjes së këtyre transaksioneve.

26. Gjendje në llogari rrjedhëse të pagës (Gjykata Kushtetuese) pranë “Raiffeisen Bank”¹², në vlerën prej 73.323 (shtatëdhjetë e tremijë e treqindnjëzetetre) lekë.

¹² Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks nr. 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së):
- nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank”, më datë 23.01.2017.

26.1. “**Raiffeisen Bank**”, me shkresën nr. *** prot., datë 28.06.2018, protokolluar pranë Komisionit me shkresën, nr. *** prot., datë 29.06.2018, ndër të tjera na konfirmon se subjekti i rivlerësimit disponon pranë kësaj banke llogarinë e pagës me nr. ***, me gjendje 374.124 lekë.

26.2. Nga verifikimi i kësaj llogarie, rezulton se, më datë 23.01.2017 (data e dorëzimit të deklaratës “Vetting”, nga subjekti i rivlerësimit pranë ILDKPKI-së), gjendja e kësaj llogari është në vlerën prej 73.323 lekësh.

26.3. Lidhur me këtë llogari Komisioni konstaton se, përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar në dosje.

27. Gjendje në llogari rrjedhëse të pagës (Universiteti “Zoja e Këshillit të Mirë”) pranë “Intesa Sanpaolo Bank”¹³, në vlerën prej 985,8 eurosh.

27.1. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga “Intesa Sanpaolo Bank”, konfirmohet se kjo është një llogari ku kreditohet paga e subjektit si pedagoge pranë Universitetit “Zoja e Këshillit të Mirë” dhe se gjendja e kësaj llogarie në datën e deklarimit ka qenë në shumën prej 985,8 eurosh.

28. Gjendje llogarie rrjedhëse¹⁴, në emër të djalit S. D, në vlerën prej 445.904 (katërqindë e dyzetë e pesëmijë e nëntëqindekatër) lekë.

28.1 *Burimi i krijimit të kësaj pasurie në deklaratën “Vetting”*: Si burim krijimi ka deklaruar kursimet e veta.

28.2 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar bankën në të cilën është kjo llogari rrjedhëse, por nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar pranë ILDKPKI-së konstatohet se, kjo llogari është në “Raiffeisen Bank”.

28.3 “**Raiffeisen Bank**”, na konfirmon këtë llogari në emër të djalit të subjektit të rivlerësimit me gjendjen prej 445.904 lekësh, në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” nga ana e subjektit të rivlerësimit.

28.4 Nga verifikimi i kësaj llogarie, vërehet se ajo kreditohet nëpërmjet transfertave nga llogaria e pagës së subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank”.

28.5 Për sa më sipër, Komisioni, konstaton se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar në dosje lidhur me gjendjen e deklaruar të kësaj llogarie.

29. Gjendje cash, në vlerën prej 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekësh.

Deklarimi veçmas i bashkëshortit (L. D) të subjektit të rivlerësimit

30. Gjendje në llogarinë rrjedhëse të pagës së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit pranë “Credins Bank”¹⁵, në vlerën prej 289.172 lekësh.

30.1. “**Credins Bank**”, me shkresën nr. *** prot., datë 19.07.2018, protokolluar pranë Komisionit me shkresën, nr. ***, datë 20.07.2018, konfirmon llogari page në “Credins Bank” në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe se gjendja e saj në datën e dorëzimit të deklaratës “Vetting” përputhet me gjendjen e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

¹³ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks nr. 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së):

- nxjerrje llogarie nga “Intesa Sanpaolo Bank”, më datë 23.01.2017.

¹⁴ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks nr. 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së):

- nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank”, më datë 23.01.2017.

¹⁵ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks nr. 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së):

- nxjerrje llogarie nga Credins Bank, më datë 23.01.2017.

31. Me deklarimin e të ardhurave, personi i lidhur ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së, kontratën e shitjes¹⁶ për automjetin, tip “Volkswagen”, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 01.12.2013, me çmim shitje prej 1.000 eurosh.

31.1 *Konkuzionet e ILDKPKI-së* lidhur me këtë rast: (1) automjeti me targë TR 5411 T, për periudhën, “para fillimit të detyrës”, deri në vitin 2013 kur ka ndodhur shitja e tij, nuk rezulton të jetë deklaruar nga bashkëshorti, z. L. D; dhe (2) nuk ka paraqitur kontratën e blerjes së këtij automjeti.

Analiza e kryer nga Komisioni:

31.2 Referuar kontratës noteriale të shitjes të dorëzuar nga ana e subjektit pranë ILDKPKI-së konstatohet se, bashkëshorti i subjektit, z. L. D, më datë 01.12.2013, ka shitur autoveturën e markës “Volkswagen”, tipi 1J, Golf, për shumën prej 1.000 eurosh.

31.3 Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të dorëzuara nga ana e subjektit të rivlerësimit ndër vite pranë ILDKPKI-së konstatohet se:

- i. në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, DPV 2011 dhe DPV 2012, në rubrikën “përbërja familjare e zyrtarit sipas certifikatës së gjendjes civile”, ka deklaruar gjendjen civile “beqare”;
- ii. në DPV 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar ndryshimin e statusit të gjendjes civile, “e martuar”.

31.4 Komisioni, vlerëson se subjekti nuk ka pasur detyrim të deklarojë këtë automjet, të shitur në vitin 2013 nga bashkëshortja i saj, pasi referuar vetëdeklarimeve të bëra pranë ILDKPKI-së, konstatohet se ka lidhur martesë në vitin 2013. Personi i lidhur, në DPV 2013, duhej ti deklaronte si të ardhura, shumën e përfituar nga shitja e këtij automjeti

31.5 Komisioni i ka kërkuar subjektit të na dërgojë një kopje të certifikatës së martesës, me qëllim konfirmimin e të dhënave të mësipërme.

31.6 Në prapësimet e sjella ndër të tjera subjekti sqaron se, ky mjet nuk është deklaruar në DPV të vitit 2013 duke konsideruar që në 31 dhjetor 2013 ky automjet nuk ka qenë më në pronësi të bashkëshortit. Mungesa e deklaramit thotë se i është konstatuar nga ILDKPI-ja më parë, prandaj për të korrigjuar këtë situatë, duke mos qenë absolutisht qëllim i bashkëshortit të mosdeklarojë automjetin në fjalë, akti i shitjes së automjetit u pasqyrua në deklaratën “Vetting”.

➤ Ka paraqitur si dokumentacion: (1) kontratën e blerjes së automjeti në vitin 2010, për vlerën 500.000 lekë; (2) kontratën e shitjes së automjetit në vitin 2013 për vlerën 1.000 euro; (3) certifikatën e martesës.

31.7 Pavarësisht se në DPV e vitit 2013, subjekti nuk i ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie, Komisioni, arsyeton se pika 2, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës ka përcaktuar detyrimin e subjektit të dorëzojë/plotësojë një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë.

31.8 Komisioni konstaton se, me dorëzimin e deklaratës “Vetting” subjekti ka deklaruar dhe ka dorëzuar dokumentacion lidhur me shitjen e këtij automjeti.

Analiza financiare e kryer nga Komisioni për vitet 2011 - 2016.

¹⁶ aneks nr. 4/10 në dosjen e ILDKPKI-së

32. Komisioni kreu një analizë financiare, për vitet gjatë të cilave për shkak të funksionit, znj. Fiona Papajorgji, është bërë subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së, për të cilat janë dërguar së bashku me dosjen e ILDKPKI-së dhe DPV-të vjetore të dorëzuara nga subjekti.

32.1. Të dhënat lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të për vitet 2011 - 2016, reflektohen në tabelën e mëposhtme:

Analiza financiare për vitet 2011 - 2016

Viti	Të ardhurat	Pasuritë	Detyrimet	Shpenzimet	Diferenca
2011	316,810	-511,001	-92,384	293,087	442,339
2012	3,984,093	2,166,385	-186,666	500,000	1,131,043
2013	2,022,740	-272,770	19,000	500,000	1,814,511
2014	2,727,309	399,982	0	500,000	1,827,328
2015	2,462,163	284,353	0	500,000	1,677,810
2016	2,687,943	450,788	0	500,000	1,737,155
TOTALI	14,201,059	2,517,736	-260,050	2,793,087	8,630,186

33. Për sa më sipër Komisioni vlerëson se, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të justifikojnë plotësisht me burime të ligjshme krijimin e pasurive (gjendjet e likuiditeteve në llogari bankare dhe ato *cash*) dhe kryerjen shpenzimeve përgjatë gjithë periudhës që ka ushtruar funksionin si këshilltare ligjore në gjykatën Kushtetuese.

Konkluzioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë

34. Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, arrin në përfundimin se: Subjekti ka kryer deklarim të saktë të pasurive dhe interesave private si edhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ajo nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të saj. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Fiona Papajorgji, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatoheshin parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

B. KONTROLLI I FIGURËS

35. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, ajo ka dërguar raportin për subjektin e rivlerësimit, me shkresën nr. *** prot., datë 26.10.2017 (deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së, nr. ***, datë 02.11.2018), në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar: **“Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Fiona Papajorgji”**. Ky raport është i deklasifikuar plotësisht.

36. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Konkluzione për vlerësimin e kontrollit të figurës

37. Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta.

38. Trupi gjykues vlerëson se, subjekti i rivlerësimit, znj. Fiona Papajorgji, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

39. Në mbështetje të pikës 2 të nenit 42 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, këshilltarët ligjorë në Gjykatën Kushtetuese vlerësohen bazuar në:

- a) *relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; dhe*
- b) *rezultatet e testimiit pranë Shkollës së Magjistraturës.*

40. Lidhur me kriterin e parë vlerësues, është përgatitur një raport i hollësishëm nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

40.1. Raporti për analizën e aftësive profesionale kryer nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e : (1) formularit të vetëdeklarimit, të tre dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; dhe (2) pesë dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

41. Në analizë të Raportit të Vlerësimit të kryer nga KLD, Komisioni vlerëson se, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është efeciente dhe efektive në masë të pranueshme.

Rezultatet e testimiit pranë Shkollës së Magjistraturës

42. Shkolla e Magjistraturës me shkresën, nr. 485 prot., datë 23.05.2018, ka dërguar rezultatet e testimiit të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit *ex officio*, të parashikuar në nenin 179/b, pika 4 të *Kushtetutës* dhe sipas parashikimeve të nenit 42 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

42.1. Rezulton se, me vendimin e Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, nr. 17, datë 21.05.2018, janë miratuar rezultatet e të dy fazave të testimiit, për vlerësimin e aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit *ex officio*, zhvilluar nga kjo shkollë në datat 7 - 8 maj 2018.

42.3. Nga verifikimi i tabelave të rezultateve konstatohet se në fazën e parë të testimit të aftësive profesionale subjekti i rivlerësimit, znj. Fiona Papajorgji, ka marrë 63 pikë nga 100 pikë të mundshme, ndërsa në fazën e dytë ka marrë 146 pikë nga 200 të mundshme.

43. Me shkresën nr. *** prot., datë 27.09.2018, Shkolla e Magjistraturës na konfirmon se, në mbështetje të nenit 165 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit, znj. Fiona Papajorgji, bën pjesë në subjektet të cilët kanë marrë të paktën 60 % të pikëve në testimin e aftësive profesionale dhe se ka të drejtë të ndjek programin dyvjeçar të trajnimit teorik dhe të praktikës profesionale në Shkollën e Magjistraturës.

44. Ndërsa, me shkresën nr. *** prot., datë 16.10.2018, Shkolla e Magjistraturës na informon se, znj. Fiona Papajorgji, këshilltare ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese, e renditur mes subjekteve që kanë arritur të paktën 60 % të pikëve të testit të aftësive profesionale, nuk e ka nënshkruar Marrëveshjen e Regjistrimit, duke hequr dorë nga a e drejta e për të ndjekur Programin dy-vjeçar të Trajnimit.

45. Në përfundim, lidhur me kriterin profesional, trupi gjykues pas propozimit të relatorit të çështjes arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel minimal kualifikues, në kuptim të nenit 59, germa c), të ligjit nr. 84/2016.

V. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të lartë të vlerësimit të aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit e rivlerësimit, znj. Fiona Papajorgji.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 26.11.2018

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI
Kryesuese

Olsi KOMICI
Anëtar

Roland ILIA
Relator

Anisa Duka
Sekretare gjyqësore